



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

**Nr. 136**

**15 gusht**

**2013**

## P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr. 631, datë 24.7.2013	Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Ekuadorit për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit të Republikës së Shqipërisë dhe diplomatike, zyrtare ose speciale të Republikës së Ekuadorit..... 5931
Vendim i KM nr. 633, datë 31.7.2013	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të z. Berti Xhambazi..... 5933
Vendim i KM nr. 634, datë 31.7.2013	Për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të z. Gjergji Pihoni..... 5934
Vendim i KM nr. 636, datë 31.7.2013	Për miratimin e marrëveshjes së grantit suedez nr. TF014255, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), që vepron si administratore e fondeve grant të siguruara nga Suedia, e përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), për bashkëfinancimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes..... 5934
Vendim i KM nr. 637, datë 31.7.2013	Për një ndryshim në vendimin nr. 372, datë 3.5.2013 të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për financimin e shpenzimeve për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, më 23 qershor 2013” ..... 5941
Vendim i KM nr. 638, datë 31.7.2013	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 31.7.2012, për ankimet nr. 604/07, nr. 43628/07, nr. 46684/07 dhe nr. 34770/09, “Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë”..... 5942

Vendim i KM nr. 639, datë 31.7.2013	Për disa ndryshime në vendimin nr. 408, datë 27.6.2012 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor bulevardi “Bajram Curri” deri në rrugën “Ali Demi”” .....	5943
Vendim i KM nr. 641, datë 31.7.2013	Për dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, nga Ministria e Mbrojtjes të Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të objektit “Tuneli i nëndetëseve” dhe të truallit funksional të tij, pjesë e pronës nr. 959, me emërtim “Ish-Brigada e Nëndetëseve”, Palermo, Himarë, për ta përdorur për ngritjen e Muzeut “Panorama e Luftës së Ftohtë”.....	5944
Vendim i ERE nr. 72, datë 18.7.2013	Mbi kërkesën e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. për dhënie udhëzimi për importin e energjisë elektrike.....	5944
Vendim i ERE nr. 73, datë 24.7.2013	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë “Hidrocentrali Cangonj” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për HEC “Cangonj” si burim i rinovueshëm energjie.....	5945
Vendim i ERE nr. 74, datë 24.7.2013	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Hidrocentrali Cangonj” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Cangonj”.....	5946
Vendim i ERE nr. 75, datë 24.7.2013	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë “Stravaj Energy” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për HEC “Stravaj” si burim i rinovueshëm energjie.....	5947
Vendim i ERE nr. 76, datë 24.7.2013	Për fillimin e procedurave për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Selca Energji” sh.p.k. me nr. 102, seria PV10P, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 39, datë 5.5.2010.....	5948
Vendim i ERE nr. 77, datë 24.7.2013	Për fillimin e procedurave për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “WTS Energji” sh.p.k. me nr. 16, seria PV04P, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 39, datë 22.7.2004.....	5949
Vendim i ERE nr. 78, datë 24.7.2013	Për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Maksi Elektrik” sh.p.k. me nr. 30, seria PV06P, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 1, datë 11.1.2006.....	5950
Vendim i ERE nr. 79, datë 24.7.2013	Për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Energy Partners - AL” sh.p.k. me nr. 118, seria PV11K, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 7, datë 2.2.2011.....	5951
Vendim i ERE nr. 80, datë 24.7.2013	Për licencimin e shoqërisë “HEC Treska” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Treska 2”, “Treska 3” dhe “Treska 4”.....	5952
Vendim i ERE nr. 81, datë 24.7.2013	Për licencimin e shoqërisë “Hidro Energy Sotira” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Sotire 1 &2”	5953
Vendim i ERE nr. 82, datë 31.7.2013	Mbi kërkesën për miratim të skedulimit të pagesave të “CEZ Shpërndarje” sh.a. (në administrim të përkohshëm), për muajin gusht 2013.....	5954

**VENDIM**  
**Nr. 631, datë 24.7.2013**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË EKUADORIT PËR  
HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË  
SHËRBIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE DIPLOMATIKE, ZYRTARE OSE  
SPECIALE TË REPUBLIKËS SË EKUADORIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Ekuadorit për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit të Republikës së Shqipërisë dhe diplomatike, zyrtare ose speciale, të Republikës së Ekuadorit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË EKUADORIT PËR HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E  
PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
DHE DIPLOMATIKE, ZYRTARE OSE SPECIALE TË REPUBLIKËS SË EKUADORIT**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës së Ekuadorit (më poshtë të quajtura “Palët Kontraktuese”),  
të nisur nga dëshira për të lehtësuar hyrjen, daljen dhe lëvizjen e shtetasve të tyre,  
kanë rënë dakord si më poshtë:

**Neni 1**

Shtetasit e Republikës së Shqipërisë, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike dhe shërbimi dhe shtetasit e Republikës së Ekuadorit, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike, zyrtare apo speciale mund të hyjnë pa viza në territorin e secilës Palë Kontraktuese dhe mund të qëndrojnë atje për një periudhë prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh brenda një afati prej 180 ditësh nga data e hyrjes.

**Neni 2**

1. Shtetasit e njëjës Palë Kontraktuese, mbajtës të pasaportave diplomatike, zyrtare apo speciale, në rastin e Ekuadorit, dhe pasaportave diplomatike dhe të shërbimit, në rastin e Shqipërisë, të punësuar në misione diplomatike, konsullore dhe organizata ndërkombëtare që kanë selitë e tyre



në territorin e Palës Kontraktuese tjetër, kanë të drejtë të hyjnë pa viza në territorin e vendin të Palës tjetër Kontraktuese gjatë kohës që janë në funksionet e tyre zyrtare.

2. Dispozitat e nenit 1 do të aplikohen, gjithashtu, për anëtarët e familjeve të tyre që banojnë me ata në të njëjtën banesë dhe posedojnë pasaporta të vlefshme diplomatike, zyrtare apo speciale për Ekuadorin dhe pasaporta diplomatike dhe shërbimi për Shqipërinë.

#### Neni 3

Shtetasit e njërës Palë Kontraktuese, mbajtës të pasaportave të përcaktuara në nenin 1 do të hyjnë, largohen dhe kalojnë transit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese në çdo pikë kufitare, të caktuar për kalim ndërkombëtar.

#### Neni 4

1. Shtetasit e njërës Palë Kontraktuese, mbajtës të pasaportave, të specifikuar në nenin 1, do të veprojnë në përputhje me ligjet dhe rregullat e tjera të Palës tjetër Kontraktuese gjatë qëndrimit në territorin e asaj Pale.

2. Kjo marrëveshje nuk do të kufizojë të drejtën e Palëve Kontraktuese, të refuzojnë hyrjen apo të anulojë qëndrimin e një shtetasi të Palës tjetër që mund ta konsiderojnë si person non grata.

#### Neni 5

1. Me qëllim mbrojtjen e sigurisë kombëtare, paqen dhe rendin social dhe shëndetin e qytetarëve të tyre, Palët Kontraktuese do të kenë të drejtë të pezullojnë pjesërisht ose tërësisht zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

2. Palët Kontraktuese do të njoftojë menjëherë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për vendimin mbi pezullimin tërësisht ose pjesërisht të kësaj marrëveshjeje ose rihyrjen e saj në huqi.

#### Neni 6

1. Palët Kontraktuese do të shkëmbejnë nëpërmjet kanaleve diplomatike ekzemplarët e pasaportave, të specifikuara në nenin 1, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje.

2. Palët Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën për ndryshimet e këtyre ekzemplarëve 60 (gjashtëdhjetë) ditë para se këto ndryshim të hyjnë në fuqi.

3. Palët Kontraktuese do të shkëmbejnë ekzemplarët e pasaportave, të specifikuara në nenin 1, të rejat apo të ndryshuarat, duke përfshirë të dhënat në lidhje me përdorimin e tyre të paktën 60 (gjashtëdhjetë) ditë para se këta ekzemplarë të futen në qarkullim.

#### Neni 7

Debatet që mund të lindin në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen nëpërmjet kanaleve diplomatike.

#### Neni 8

Kjo marrëveshjeje lidhet për një kohë të pacaktuar, secila Palë Kontraktuese mund ta anulojë këtë marrëveshjeje në çdo kohë, duke i dërguar njoftim me shkrim Palës tjetër Kontraktuese nëpërmjet

kanaleve diplomatike. Marrëveshja pushon së vepruari 90 (nëntëdhjetë) ditë nga data e marrjes nga Pala tjetër e këtij njoftimi.

#### Neni 9

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes të notës diplomatike të fundit me anën e së cilës Palët Kontraktuese informojnë njëra-tjetrën se kanë plotësuar të gjitha kushtet e parashikuara në legjislacionin e tyre për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Bërë në Vjenë, datë 4.6.2013, në dy kopje origjinale, në gjuhët shqipe, spanjolle dhe angleze, duke qenë të dyja tekstet me vlerë të njëjtë. Në rast mosmarrëveshjesh në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

**PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**Vili Minarolli**

Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i  
Republikës së Shqipërisë në Austri

**PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË  
EKUADORIT**

**Juan Diego Stacey Moreno**

Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i  
Republikës së Ekuadorit në Austri

#### **VENDIM**

**Nr. 633, datë 31.7.2013**

#### **PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË Z. BERTI XHAMBAZI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

#### **VENDOSI:**

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, zëri “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 11 200 000 (njëmbëdhjetë milionë e dyqind mijë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të z. Berti Xhambazi.

2. Fondi prej 11 200 000 (njëmbëdhjetë milionë e dyqind mijë) lekësh të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI  
Sali Berisha**



**VENDIM**  
**Nr. 634, datë 31.7.2013**

**PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË**  
**Z. GJERGJI PIHONI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Mbulimin e pjesëshëm të shpenzimeve të kurimit të z. Gjergji Pihoni, me detyrë përgjegjës i sektorit të përfaqësimit gjyqësor në Drejtorinë Juridike në Ministrinë e Mbrojtjes, në masën 1 020 000 (një milion e njëzet mijë) lekë.
2. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2013, programi “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi”, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.
3. Pagesa të bëhet kundrejt paraqitjes së faturave origjinale të institucionit shëndetësor të kurimit.
4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr. 636, datë 31.7.2013**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT SUEDEZ NR. TF014255, NDËRMJET**  
**SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**  
**(IBRD), QË VEPRON SI ADMINISTRATORE E FONDEVE GRANT TË SIGURUARA NGA**  
**SUEDIA, E PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA SUEDEZE PËR BASHKËPUNIM DHE**  
**ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR (SIDA), PËR BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTIT TË**  
**BURIMEVE UJORE DHE UJITJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e marrëveshjes së grantit suedez nr. TF 014255, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), që vepron si administratore e fondeve grant të siguruar nga Suedia, e përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), për bashkëfinancimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

<b>Banka Botërore</b>	1818 H Street N.W.	(202) 477-1234
Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim	Washington, D.C.	Adresa kablllore:
INTBAFRAD	20433	
SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM	SHBA	Adresa kablllore: INDEVAS

(data e nënshkrimit nga drejtori i vendit), 2013

SHT Ridvan Bode  
Ministër i Financave  
Ministria e Financave  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”  
Tirana / Shqipëri

Lënda: Granti suedez për bashkëfinancimin e  
Projektit të burimeve ujore dhe ujitjes në Shqipëri

**Granti nr. TF014255**

Shkëlqesi:

Në përgjigje të kërkesës për asistencë financiare të bërë në emër të Shqipërisë (Përfituesi), jam i kënaqur t’ju informoj që Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), që vepron si administrator i fondeve të dhëna nga Suedia, e përfaqësuar nga Agjencia Suedeze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA) (Donatori), propozon dhënien ndaj Përfituesit të një granti në një shumë që nuk kalon katër milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë dollarë amerikanë (US\$ 4,675,000) (grantit) sipas termave dhe kushteve të përcaktuar ose të përmendur në këtë letër marrëveshje (marrëveshja), që përfshin aneksin e bashkëngjitur, për të asistuar në financimin e projektit të përshkruar në aneks (projekti). Qëllimi i grantit është bashkëfinancimi i një projekti për burimet ujore dhe ujitjes, për të cilin Shqipërisë i është dhënë një hua (numri i huas së IBRD-së 8211-AL), në pajtim me marrëveshjen ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Botërore me datë 14 dhjetor 2012 në shumën e tridhjetë e një milionë eurove (€ 31,000,000) (marrëveshja e huas e IBRD-së).

Ky grant financohet nga fondi i besimit të sipërpërmendur për të cilin Banka Botërore merr kontribute periodike nga Donatori. Në pajtim me seksionin 3.02 të kushteve standarde (sipas përkufizimit në aneksin e kësaj marrëveshjeje), detyrimet për pagesë të Bankës Botërore në lidhje me këtë marrëveshje kufizohen në shumën e fondeve të ofruara nga donatorët sipas fondit të besimit të sipërpërmendur dhe e drejta e Përfituesit për të tërhequr shumën e grantit i nënshtrohet disponibilitetit të këtyre fondeve.

Përfituesi përfaqëson, duke konfirmuar pëlqimin e tij më poshtë, që është i autorizuar të lidhë këtë marrëveshje dhe të zbatojë projektin në pajtim me termat dhe kushtet e parashikuar ose të përmendur në këtë marrëveshje.

Jeni të lutur të konfirmoni pëlqimin e Përfituesit për sa më sipër, duke caktuar një nëpunës të autorizuar të Përfituesit të nënshkruajë dhe të vendosë datën në kopjen e bashkëngjitur të kësaj



marrëveshjeje dhe t'ia kthejë atë Bankës Botërore. Pas marrjes nga Banka Botërore të kësaj kopjeje të kundërfirmuar, kjo marrëveshje hyn në fuqi pas njoftimit nga Përfituesi të përfundimit të procedurave të tij të brendshme; megjithatë, me kusht që oferta e kësaj marrëveshjeje të konsiderohet e tërhequr nëse Banka Botërore nuk ka marrë kopjen e kundërfirmuar të kësaj marrëveshjeje dhe njoftimin përkatës brenda 60 ditëve pas datës së nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje nga Banka Botërore, përveç kur Banka ka vendosur një datë të mëvonshme për këtë qëllim.

Shumë sinqerisht i juaji,

**BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

Nga \_\_\_\_\_  
Ellen Goldstein  
Drejtor Vendi për Ballkanin Perëndimor  
Europën dhe Rajonin e Azisë Qendrore

**RËNË DAKORD:**

**SHQIPËRI**

Nga: \_\_\_\_\_  
Përfaqësues i autorizuar  
Emri: \_\_\_\_\_  
Titulli: \_\_\_\_\_  
Datë: \_\_\_\_\_

**Bashkëngjitur:**

1. Kushtet standarde për grantet e dhëna nga Banka Botërore nga fonde të ndryshme, të datës 15 maj 2012.
2. Letër disbursimi e së njëjtës datë si e kësaj marrëveshjeje, së bashku me udhëzimet e Bankës Botërore për disbursimet të datës 1 maj 2006.

**Granti i SIDA-s nr. TF014255**  
**ANEKSI**

**Neni 1**

**Kushtet standarde; përkufizime**

1.01 Kushtet standarde. Kushtet standarde për grantet e dhëna nga Banka Botërore nga fonde të ndryshme të datës 15 shkurt 2012 (kushte standarde) përbëjnë një pjesë integrale të kësaj marrëveshjeje.

1.02 Përkufizime. Përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat me germa kapitale të përdorur në këtë marrëveshje kanë kuptimet e veshura atyre në kushtet standarde, marrëveshjen e huas së IBRD-së ose në këtë marrëveshje.

**Neni 2**

**Zbatimi i projektit**

2.01 Objektivi dhe përshkrimi i projektit. Objektivi i projektit është bashkëfinancimi i pjesëve 3 dhe 4 të projektit të burimeve ujore dhe ujitjes (huaja 8211-AL), që synon vendosjen e kuadrin strategjik për menaxhimin e burimeve ujore në nivel kombëtar dhe në basenet e lumenjve Drin-Buna dhe Seman. Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa 3: Mbështetja institucionale për menaxhimin e integruar të burimeve ujore



Realizimi i punëve, shërbimeve të konsulentëve, mallrave dhe trajnimit për vendosjen e një kuadri strategjik për menaxhimin e burimeve ujore, nëpërmjet:

- i) përgatitja e një strategjie kombëtare për menaxhimin e integruar të burimeve ujore;
- ii) përgatitja e planeve të menaxhimit të baseneve lumore për basenet e lumenjve Drin-Bunë dhe Seman; dhe
- iii) krijimi i një baze të plotë të dhënash për burimet ujore që përdoret si bazë për planifikimin dhe programimin kombëtar të burimeve ujore.

#### Pjesa 4: Mbështetja e zbatimit

Realizimi i punëve, asistencës teknike, trajnimit, pajisjeve të zyrës dhe automjeteve, dhe kostoja operative shtuese në mbështetje të menaxhimit të projektit dhe vendosja dhe zbatimi i një sistemi informativ menaxherial bazuar në performancë.

2.02 Zbatimi i projektit në përgjithësi. Përfituesi deklaron angazhimin e tij për objektivin e projektit. Për këtë qëllim, Përfituesi e realizon projektin nëpërmjet Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU) në pajtim me dispozitat e: a) Nenit II të kushteve standarde; b) “Udhëzimeve për parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e financuara nga huat e IBRD-së dhe kredive dhe granteve të IDA-s”, të datës 15 tetor 2006, dhe rishikuar në janar 2011 (udhëzimet antikorrupsion); dhe c) këtij neni 2.

2.03 Masat institucionale dhe të tjera. Përfituesi e realizon projektin në pajtim me manualin e operacioneve të projektit dhe nuk ndryshon, pezullon, abrogon, shfuqizon apo heq dorë nga ndonjë dispozitë e Manualit të Operacioneve të Projektit pa aprovimin paraprak të Bankës.

#### 2.04 Garancitë

##### a) Mbrojtja e mjedisit dhe rivendosja

Përfituesi, nëpërmjet MBUMK-së dhe MMPAU-së realizon ose merr masa për realizimin e veprimeve të mëposhtme: a) zbaton kuadrin e garantimit mjedisor dhe social; b) përgatit dhe i paraqet Bankës Botërore për aprovim plane specifike lokale të menaxhimit mjedisor dhe social (duke përfshirë masat për menaxhimin e pestit) në pajtim me kuadrin e garantimit mjedisor dhe social; dhe c) zbaton këto plane specifike lokale të menaxhimit mjedisor dhe social që janë aprovuar nga Banka Botërore, të gjitha në mënyrë të pranueshme për Bankën Botërore dhe të nevojshme për të siguruar që projekti të zbatohet në pajtim me praktikën dhe standardet e shëndosha mjedisore.

b) Pa u kufizuar në nënparagrafin “a” të këtij paragrafi për mbrojtjen mjedisore dhe rivendosjen, Përfituesi nuk fillon tenderimin për punët sipas projektit derisa Banka Botërore të ketë aprovuar planin specifik lokal të menaxhimit mjedisor dhe social për këto punë në pajtim me dispozitën e këtij nënparagrafi 2.04(a).

##### c) Përfituesi, nëpërmjet MBUMK-së dhe MMPAU-së:

i) merr të gjitha masat e nevojshme për të minimizuar në masën e mundur çdo humbje të pavullnetshme nga personat të strehimit, mjeteve prodhuese ose mundësinë e mjeteve prodhuese ose të ardhurat apo mjetet e jetesës, përkohësisht apo përgjithmonë në realizimin e projektit; dhe

ii) kurdoherë që zbatimi i projektit ose modifikimi/finalizimi i një dizenoje apo punë të projektit do të kishte si pasojë persona të zhvendosur, para fillimit të punëve në lidhje me këtë zbatim, modifikim apo finalizim, i paraqet Bankës Botërore për rishikim dhe aprovim një plan veprimi specifik lokal veprimi rivendosës të përgatitur në pajtim me parimet dhe procedurat e parashikuara në Kuadrin e Politikës së Rivendosjes dhe, pas kësaj, zbaton në një mënyrë të pranueshme për Bankën Botërore (që përfshin, përveç kur bihet dakord ndryshe nga Banka Botërore, pagesën e plotë të kompensimit për të gjithë personat e zhvendosur) atë plan specifik lokal të veprimit rivendosës që është aprovuar nga Banka Botërore.

2.05 Vizibiliteti dhe vizitat e Donatorit. a) Përfituesi merr ose realizon marrjen e të gjitha masave që Banka Botërore mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të identifikuar publikisht mbështetjen e Donatorit për projektin.



b) Për qëllimet e seksionit 2.09 të kushteve standarde, Përfituesi, me kërkesën e Bankës Botërore, merr të gjitha masat e kërkuara nga ana e saj për t'u mundësuar përfaqësuesve të Donatorit të vizitojnë çdo pjesë të territorit të Përfituesit për qëllimet në lidhje me projektin.

2.06 Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i projektit. a) Përfituesi, nëpërmjet MMPAU-së, monitoron dhe vlerëson përparimin e projektit dhe përgatit raporte të projektit në pajtim me dispozitat e seksionit 2.06 të kushteve standarde dhe mbi bazën e treguesve të pranueshëm për Bankën Botërore. Çdo raport-projekti mbulon periudhën e një semestri kalendarik dhe i paraqitet Bankës Botërore jo më vonë se 45 ditë pas përfundimit të periudhës së mbuluar nga ky raport.

b) Përfituesi nëpërmjet MMPAU-së përgatit raportin e përfundimit në pajtim me dispozitat e seksionit 2.06 të kushteve standarde. Raporti i përfundimit i paraqitet Bankës Botërore jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së mbylljes.

2.07 Menaxhimi financiar. a) Përfituesi garanton pasjen e një sistemi të menaxhimit financiar në pajtim me dispozitat e seksionit 2.07 të kushteve standarde.

b) Përfituesi, nëpërmjet MMPAU-së, siguron përgatitjen e raporteve financiare të brendshme të paaudituar të projektit dhe t'i paraqiten Bankës Botërore jo më vonë se 45 ditë pas përfundimit të çdo semestri kalendarik, që mbulon semestrin në formë dhe në përmbajtje të pranueshme për Bankën Botërore.

c) Përfituesi nëpërmjet MMPAU-së auditon pasqyrat financiare të tij në lidhje me projektin në pajtim me dispozitat e seksionit 2.07(b) të kushteve standarde. Çdo auditim i tillë i pasqyrave financiare mbulon periudhën e një viti fiskal të Përfituesit. Pasqyrat financiare të audituara për çdo periudhë të tillë duhet t'i paraqiten Bankës Botërore jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të kësaj periudhe.

#### 2.08 Prokurimi

a) Të përgjithshme. Të gjitha mallrat, punët dhe shërbimet e konsulentëve që kërkohen për projektin dhe që duhet të financohen nga shumat e grantit prokurohen në pajtim me kërkesat e përcaktuara dhe të përmendura në:

i) seksionin I të "Udhëzimeve: Prokurimi i mallrave, punëve dhe shërbimet jokonsulente sipas huave të IBRD-së dhe kredive dhe granteve të IDA-s nga Huamarrësit e Bankës Botërore" të datës janar 2011 (udhëzimet e prokurimit), në rastin e mallrave, punëve dhe shërbimeve të jokonsulencës;

ii) seksionet I dhe IV të "Udhëzimeve: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve sipas huave të IBRD-së dhe kredive dhe granteve të IDA-s nga Huamarrësit e Bankës Botërore" të datës janar 2011 (udhëzimet për konsulentët) në rastin e shërbimeve të konsulentëve; dhe

iii) dispozitat e këtij seksioni, ku e gjitha shtjellohet në planin e prokurimit të përgatitur dhe përditësuar herë pas here nga Përfituesi nëpërmjet MMPAU-së për projektin në pajtim me paragrafin 1.18 të udhëzimeve të prokurimit dhe paragrafin 1.25 të udhëzimeve të Konsulentit (plani i prokurimit).

b) Përkufizime. Termat me germa kapitale të përdorur në paragrafët e mëposhtëm të këtij seksioni për të përshkruar metodat e veçanta të prokurimit ose metodat e rishikimit nga Banka Botërore të kontratave të veçanta, i referohen metodës së përshkruar në seksionet II dhe III të udhëzimeve të prokurimit, ose seksioneve II, III, IV dhe V të udhëzimeve të konsulentit, sipas rastit.

c) Metoda të veçanta të prokurimit të mallrave dhe punëve

i) përveç kur parashikohet ndryshe në nënparagrafin "ii" më poshtë, mallrat dhe punët prokurohen sipas kontratave të dhëna mbi bazën e ofertimit konkurrues ndërkombëtar.

ii) metodat e mëposhtme, të ndryshme nga ofertimi konkurrues ndërkombëtar, mund të përdoret për prokurimin e mallrave dhe punëve për ato kontrata që specifikohen në planin e prokurimit: A) Blerjet; B) Kontraktimi i drejtpërdrejtë; dhe C) Ofertimi konkurrues kombëtar, në pajtim me dispozitat e mëposhtme shtesë:

Modifikimet në procedurat ofertuese konkurruese kombëtare të Përfituesit

Procedurat ofertuese konkurruese kombëtare (NCB) bazohen në procedurat e hapura të tenderimit sipas përcaktimit në ligjin e prokurimit publik (PPL) të Shqipërisë (ligji nr. 9643, datë 20 nëntor 2006, i ndryshuar), me kusht që kjo procedurë t'u nënshtrohet dispozitave të seksionit I dhe paragrafëve 3.3 dhe 3.4 të udhëzimeve të prokurimit dhe dispozitave të mëposhtme shtesë:

i) procedurat e “tenderimit të hapur” sipas përcaktimit në PPL-në e Shqipërisë zbatohen për të gjitha kontratat e financuara nga Banka Botërore;

ii) ofertuesit e huaj nuk përjashtohen nga ofertimi dhe asnjë preferencë e asnjë lloji nuk u jepet ofertuesve vendas në procesin e ofertimit. Ndërmarrjet në pronësi të qeverisë në Shqipëri lejohen të ofertojnë vetëm nëse janë ligjërish dhe financiarisht autonome dhe operojnë sipas ligjit tregtar të Republikës së Shqipërisë. Regjistrimi nuk përdoret për të vlerësuar kualifikimet e ofertuesve;

iii) ofertat hapen në publik në një vend, menjëherë pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave në prani të përfaqësuesve të atyre që marrin pjesë;

iv) subjektet prokuruese përdorin dokumente ofertuese model të aprovuar nga Banka Botërore;

v) në rastin e çmimeve më të larta të ofertës sipas vlerësimit zyrtar, të gjitha ofertat nuk refuzohen pa rakordim të mëparshëm me Bankën Botërore;

vi) zbatohet një procedurë me një zarf të vetëm për paraqitjen e ofertave;

vii) paskualifikimi zhvillohet vetëm bazuar në ofertuesin me vlerësim më të ulët; asnjë ofertë nuk refuzohet në momentin e hapjes së ofertës për shkaqe kualifikimi;

viii) ofertuesit në një formë ndërmarrjeje të përbashkët janë të detyruar solidarisht dhe individualisht;

ix) para refuzimit të të gjitha ofertave dhe kërkimit të ofertave të reja, merret pëlqimi paraprak i Bankës Botërore;

x) kontratat i jepen ofertuesit me vlerësim më të ulët, që është thelbësisht reagues, i cili përcaktohet si i kualifikuar për të operuar në pajtim me kriteret e parapërcaktuara dhe të parashpallura të vlerësimit;

xi) bisedimet pas ofertimit lejohen me ofertuesin me vlerësimin më të ulët dhe me ofertues të tjerë;

xii) kontratat me kohëzgjatje të gjatë (më shumë se 18 muaj) përmbajnë dispozita të përshtatshme për rregullimin e çmimit;

xiii) garancitë e ofertës dhe kontratës janë në formën e përfshirë në dokumentet e ofertimit. Garancia e ofertës është e vlefshme për njëzet e tetë (28) ditë tej periudhës fillestare të vlefshmërisë të ofertës, ose tej çdo periudhe të shtyrjes nëse kërkohet. Nuk bëhet asnjë parapagesë pa një garanci të përshtatshme të parapagimit;

xiv) dokumentet e ofertimit dhe kontratat që konsiderohen të pranueshme nga Banka Botërore përfshijnë dispozita që përcaktojnë politikën e Bankës Botërore për të sanksionuar firmat ose individët që konstatohen të përfshirë në mashtrim dhe në korrupsion sipas përcaktimit të udhëzimeve të prokurimit;

xv) në pajtim me udhëzimet e prokurimit, çdo dokument ofertimi dhe kontratë e financiar nga shumat e huas parashikon që ofertuesit, furnitorët dhe kontraktorët dhe nënkontraktorët, agjentët, personeli, konsulentët, dhënësit e shërbimeve ose furnitorët e tyre të lejojnë që Banka Botërore të inspektojë të gjitha llogaritë, regjistrat dhe dokumentet e tjera në lidhje me paraqitjen e ofertave dhe realizimin e kontratës dhe të auditohen ato nga auditë të caktuar nga Banka Botërore. Veprimet që synojnë të pengojnë materialisht ushtrimin e së drejtës së Bankës Botërore për inspektim dhe auditim të parashikuar në udhëzimet e prokurimit përbëjnë një praktikë penguese sipas përkufizimit në udhëzimet e prokurimit.

d) Metoda të veçanta të prokurimit të shërbimeve të konsulentëve



i) përveç kur parashikohet ndryshe në pikën “ii” më poshtë, shërbimet e konsulentëve prokurohen sipas kontratave të dhëna mbi bazën e përzgjedhjes bazuar në cilësi dhe kosto;

ii) metodat e mëposhtme, të ndryshme nga përzgjedhja bazuar në cilësi dhe kosto, mund të përdoret për prokurimin e shërbimeve të konsulentëve për ato detyra që specifikohen në planin e prokurimit: A) Përzgjedhje bazuar në cilësi; B) Përzgjedhje sipas një buxheti të prerë; C) Përzgjedhje me koston më të ulët; D) Përzgjedhje e bazuar në kualifikimet e konsulentëve; E) Përzgjedhje me një burim të vetëm të firmave konsulente; F) Përzgjedhja e konsulentëve individualë; dhe G) Procedurat me një burim të vetëm për zgjedhjen e konsulentëve individualë.

e) Rishikimi nga Banka Botërore të vendimeve të prokurimit. Plani i prokurimit përcakton ato kontrata që i nënshtrohen rishikimit paraprak të Bankës Botërore. Të gjitha kontratat e tjera i nënshtrohen rishikimit pasues të Bankës Botërore.

### Neni 3

#### Tërheqja e shumave të grantit

3.01 Shpenzime të përshtatshme. Përfituesi mund të tërheqë shumat e grantit në pajtim me dispozitat e: a) kushteve standarde; b) këtij seksioni; dhe c) atyre udhëzimeve shtesë që Banka Botërore mund të specifikojë nëpërmjet njoftimit drejtuar Përfituesit (duke përfshirë “Udhëzimet e disbursimit të Bankës Botërore për projektet” të datës maj 2006, të rishikuar herë pas here nga Banka Botërore që bëhet e zbatueshme për këtë marrëveshje në pajtim me këto udhëzime), për të financuar shpenzimet e përshtatshme të parashikuara në tabelën e mëposhtme, tabela specifikon kategoritë e shpenzimeve të përshtatshme që mund të financohen nga shumat e grantit (kategoria), alokimet e shumave të grantit për çdo kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që financohen për shpenzimet e përshtatshme në çdo kategori:

Kategoria	Shuma e grantit të alokuar (shprehur në USD)	Përqindja e shpenzimeve që duhet të financohen (përfshirë tatimet)
1) Punët, mallrat, shërbimet e konsulentëve, trajnimi dhe kostoja operative shtuese për pjesët 3 dhe 4 të projektit	4.675.000	100%
<b>SHUMA TOTALE</b>	<b>4.675.000</b>	

Për qëllimet e këtij seksioni, “Kostot operative shtuese” janë kostot e arsyeshme shtuese administrative të administratës së MBUMK-së dhe MMPAU-së në lidhje me zbatimin e aktiviteteve të projektit, duke përfshirë mirëmbajtjen e zyrës, pajisjet, mobiliet, materialet dhe furnizimet, koston e komunikimit dhe koston e karburantit për vizitat në terren.

3.02 Kushtet e tërheqjes, pavarësisht dispozitave të seksionit 3.01 të kësaj marrëveshjeje, asnjë tërheqje nuk bëhet për pagesat e bëra para datës së kundërfirmimit të kësaj marrëveshjeje nga Përfituesi.

3.03 Periudha e tërheqjes, data e mbylljes e përmendur në seksionin 3.06(c) të kushteve standarde është 31 maj 2018.

Neni 4

**Përfaqësuesi i Përfituesit; adresat**

4.01 Adresa e përfaqësuesit. Përfaqësuesi i përmendur në seksionin 7.02 të kushteve standarde është Ministri i Financave.

4.02 Adresa e përfituesit. Adresa e Përfituesit e përmendur në seksionin 7.01 të kushteve standarde është:

Ministria e Financave  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1  
Tirana / Shqipëri  
Tel. Faks:  
355-4-222-8405 355-4-222-8494

4.03 Adresa e Bankës Botërore. Adresa e Bankës Botërore e përmendur në seksionin 7.01 të kushteve standarde është:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim  
1818 H Street, N.W.  
Washington, D.C. 20433  
Shtetet e Bashkuara të Amerikës  
Kabëll: Teleks: Faks:  
INTBAFRAD 248423 (MCI) ose 1-202-477-6391  
Washington, D.C. 64145 (MCI)

**VENDIM**

**Nr. 637, datë 31.7.2013**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 372, DATË 3.5.2013 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR  
PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR FINANCIMIN E SHPENZIMEVE  
PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,  
MË 23 QERSHOR 2013”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pika 1 e vendimit nr. 372, datë 3.5.2013 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të vitit 2013, t’i shtohet një fond prej 521 000 000 (pesëqind e njëzet e një milionë) lekësh, nga i cili 45 000 000 (dyzet e pesë milionë) lekë, për shpenzime personeli, për kryerjen e pagesave për komisionerët e KZAZ-ve, qendrave të votimit dhe grupeve të numërimit; 436 000 000 (katërqind e tridhjetë e gjashtë milionë) lekë, për shpenzime operative, për projektet SEN dhe SEV, dhe 40 000 000 (dyzet milionë) lekë për shpenzime për investime.”.



2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

## VENDIM

Nr. 638, datë 31.7.2013

### **PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 31.7.2012, PËR ANKIMET NR. 604/07, NR. 43628/07, NR. 46684/07 DHE NR. 34770/09, “MANUSHAQE PUTO DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrisë të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Ekzekutimin e pjesshëm të vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 31.7.2012, për ankimet nr. 604/07, nr. 43628/07, nr. 46684/07 dhe nr. 34770/09, “Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, në masën 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, si dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat për dëmshpërblimin.

2. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të paguhet menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe për të përlogaritur vlerën në euro të detyrimit të shlyer të mbahet në konsideratë kursi i këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

Pjesa e mbetur e detyrimit të përcaktuar në vendimin e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 31.7.2012, për ankimet nr. 604/07, nr. 43628/07, nr. 46684/07 dhe nr. 34770/09, “Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, të paguhet sipas afateve të përcaktuara me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

Ministria e Financave të marrë masat e nevojshme për gjetjen e mundësisë financiare për ekzekutimin e pjesës së mbetur të detyrimit, brenda afateve sa më të shpejta. Ministria e Financave njofton Ministrinë e Drejtësisë për nisjen e procedurave për ekzekutimin e detyrimit në varësi të mundësisë financiare për përballimin e saj.

3. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në njërën nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesve, në vlerë proporcionale me detyrimin që ka shteti shqiptar për secilin prej tyre, sipas vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 31.7.2012, për ankimet nr. 604/07, nr. 43628/07, nr. 46684/07 dhe nr. 34770/09, “Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë”.

4. Pagimi i shumës së depozituar sipas pikës 3 të këtij vendimi, në favor të ankuesve, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes të të gjithë dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.

5. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondet e papërdorura të KQZ-së për mosaplikimin e dy projekteve të teknologjisë për procedurat zgjedhore 5942

sipas vendimit nr. 372, datë 3.5.2013 të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për financimin e shpenzimeve për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, më 23 qershor 2013”.

6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr. 639, datë 31.7.2013**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 408, DATË 27.6.2012 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR BULEVARDI “BAJRAM CURRI” DERI NË RRUGËN “ALI DEMI””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në listën bashkëlidhur vendimit nr. 408, datë 27.6.2012 të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Numri rendor 10 ndryshohet sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.

b) Numri i pasurisë për bashkëpronarët “Mema”, nga “8/644” bëhet “8/762”.

2. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës së kompensimit përkatës që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Kompensimi i pronarëve, për efekt shpronësimi, të fillojë më 15.8.2013.

4. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’u vihet në dispozicion nga Bashkia e Tiranës, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

5. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

6. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Bashkia e Tiranës, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**

**BULEVARDI "BAJRAM CURRI" - RRUGA " ALI DEMI, FAZA E II-TE**

*(korrigjimi)*

Nr.	Pronari	Z.K	Nr.		Truall (ishte)			Nr			truall (behet)			Vlera	Pershkrim
			Pas. Ishte		Sip. Cmimi	Vlera ne leke	Pas behet	Sip. m2	Cmimi	Vlera ne leke	Sip. m2	Cmimi	Vlera ne leke		
10	Bashkepronaret Mema	8150	8/644		45	29829	1342305	8762	45	29829				1342305	rikonfirmim
	<b>TOTALI</b>				<b>45</b>		<b>1342305</b>		<b>45</b>				<b>1342305</b>	<b>1342305</b>	

Ne list ndryshon vetem numri i pasurise se prones, te gjitha te dhenat e tjera jane te njejta sipas VKM-se nr. 408 Dt. 27. 06. 2012 te miratuar





**VENDIM**

**Nr. 641, datë 31.7.2013**

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE TË OBJEKTIT “TUNELI I NËNDETËSEVE” DHE TË TRUALLIT FUNKSIONAL TË TIJ, PJESË E PRONËS NR. 959, ME EMËRTIM “ISH-BRIGADA E NËNDETËSEVE”, PALERMO, HIMARË, PËR TA PËRDORUR PËR NGRITJEN E MUZEUT “PANORAMA E LUFTËS SË FTOHTË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 3 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të nenit 901 e vijues të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë e Sporteve dhe të Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të objektit “Tuneli i nëndetëseve” dhe të truallit funksional të tij, me sipërfaqe 15 859 (pesëmbëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë) m<sup>2</sup>, pjesë e pronës nr. 959, me emërtim “Ish-Brigada e Nëndetëseve”, me vendndodhje në Palermo, Himarë, për një periudhë 20-vjeçare, sipas planvendosjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për ta përdorur për realizimin e projektit të Muzeut “Panorama e Luftës së Ftohtë”.

2. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të nxjerrin aktet e nevojshme për dhënien në përdorim të objekteve, duke përcaktuar detyrimet për secilin institucion dhe duke përcaktuar modalitetet e moscenimit të veprimtarisë së Forcave të Armatosura.

4. Ngarkohen Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**

**Nr. 72, datë 18.7.2013**

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA PËR DHËNIE UDHËZIMI PËR IMPORTIN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të pikës 4.8 të Modelit të Tregut, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, pikës 3.1 dhe 3.16.4 të licencës së shpërndarjes së energjisë elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.7.2013, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” për dhënie udhëzimeve për importin e energjisë elektrike dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Licencimit, pasi konstatoi:

- OSSH-ja është përgjegjëse për importin e energjisë elektrike për të mbuluar të gjitha humbjet në sistemin e shpërndarjes;
- Se statusi i administrimit të përcaktuar në nenin 18 pika 4 germa “c” të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, është i përkohshëm;
- Gjendjen financiare të shoqërisë, duke pasur parasysh operimin në bazë të një skeduli të pagesave;
- Humbjet faktike në sistemin e shpërndarjes përlogariten rreth datës 14 të muajit pasardhës, që e bën prokurimin në bazë mujore të jetë më afër realitetit.

VENDOSI:

1. “CEZ Shpërndarje” të kryejë procedurat për prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve mbi baza mujore për periudhën gusht-dhjetor 2013.
2. “CEZ Shpërndarje” për prokurimin e energjisë elektrike mbi bazë mujore duhet të zbatojë procedurat e përcaktuara në rregulloren e prokurimit të energjisë elektrike nga ana e OSSH-së miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 42, datë 25.5.2009.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Sokol Ramadani

VENDIM  
Nr. 73, datë 24.7.2013

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË  
“HIDROCENTRALI CANGONJ” SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES  
PËR HEC “CANGONJ” SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 18 pika 1 germa “d” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009 dhe neneve 7 dhe 8 të Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 24.7.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hidrocentrali Cangonj” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për HEC “Cangonj” si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Hidrocentrali Cangonj” sh.p.k., është konform Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, korografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”



Përshkrimi i centralit...

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Hidrocentral Cangonj” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues për HEC “Cangonj” si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**

#### VENDIM

**Nr. 74, datë 24.7.2013**

### **PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HIDROCENTRALI CANGONJ” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “CANGONJ”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “a” dhe nenit 10 pikat 1, 3 dhe 4 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1 germa “a” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.7.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hidrocentrali Cangonj” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hidrocentrali Cangonj” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Neni 9, pika 4.1.5 leje nga institucione të tjera:  
Është plotësuar pjesërisht. Është në proces miratimi i pikës së lidhjes me rrjetin e shpërndarjes.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Hidrocentrali Cangonj” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Cangonj”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**

**VENDIM**

**Nr. 75, datë 24.7.2013**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË  
“STRAVAJ ENERGY” SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES PËR HEC  
“STRAVAJ” SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, nenit 18 pika 1 germa “d” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009 dhe neneve 7 dhe 8 të Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 24.7.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Stravaj Energy” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues për HEC “Stravaj” si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Stravaj Energy” sh.p.k., është konform rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme si më poshtë:

- Neni 7, pika 1 , gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, korografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit...

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s



VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Stravaj Energy” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues për HEC “Stravaj” si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të e ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr. 76, datë 24.7.2013

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT  
TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “SELCA ENERGJI” SHPK ME NR. 102,  
SERIA PV10P, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S  
NR. 39, DATË 5.5.2010**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, si dhe nenet 10 dhe 15 pikat 1 dhe 2 germa “b” pika 4 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18 pika 1 germa “a” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.7.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Selca Energji” sh.p.k., për ndryshimin e licencës nr. 102, seria PV10P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 39, datë 5.5.2010 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Selca Energji” sh.p.k. plotëson kërkesat e “Rregullores së procedurave të licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”:

Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës (është plotësuar tërësisht).

- Neni 15, pika 4, germa “b”:

Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence (është plotësuar tërësisht).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e licencës së shoqërisë “Selca Energji” sh.p.k. me nr. 102, seria PV10P, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Selce” me fuqi 400 KW, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 39, datë 5.5.2010.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr. 77, datë 24.7.2013

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT  
TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “WTS ENERGJI” SHPK ME NR. 16,  
SERIA PV04P, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S  
NR. 39, DATË 22.7.2004**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, si dhe nenet 10 dhe 15 pikat 1 dhe 2 germa “b” pika 4 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18 pika 1 germa “a” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.7.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “WTS Energji” sh.p.k. për ndryshimin e licencës nr. 16, seria PV04P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 39, datë 22.7.2013 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “WTS Energji” sh.p.k. plotëson kërkesat e “Rregullores së procedurave të licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”:

Informacioni me shkrim, ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës (është plotësuar tërësisht).

- Neni 15, pika 4, germa “b”:

Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence (është plotësuar tërësisht).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s



VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e licencës së shoqërisë “WTS Energji” sh.p.k. me nr. 16, seria PV04P, për prodhimin e energjisë elektrike, nga HEC “Tamare” me fuqi 180 KW, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 39, datë 22.7.2004.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr. 78, datë 24.7.2013

**PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “MAKSI ELEKTRIK” SHPK ME NR. 30, SERIA PV06P, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 1, DATË 11.1.2006**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 13, 14 pika 2, 15 pika 1, pika 2 germa “b”, pika 3 pika 4 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, pikat 2.3 dhe 2.4 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.7.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Maksi Elektrik” sh.p.k. për ndryshimin e licencës nr. 30, sSeria PV06P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 1, datë 11.1.2006 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Maksi Elektrik” sh.p.k. plotëson kërkesat e “Rregullores së procedurave të licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”:

Informacioni me shkrim, ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës (është plotësuar tërësisht).

- Neni 15, pika 4, germa “b”:

Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence (është plotësuar tërësisht).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Modifikimin e licencës së shoqërisë “Maksi Elektrik” me nr. 30, seria PV06P, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et “Leskovik 1” me fuqi 72 KW dhe “Leskovik 2” me fuqi 100 KW, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 1, datë 11.1.2006.

2. Fuqia e instaluar e HEC “Leskovik 1” nga 72 KW të bëhet 1072 KW dhe fuqia e instaluar e HEC “Leskovik 2” nga 100 KW të bëhet 1100 KW.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Sokol Ramadani

**VENDIM**  
**Nr. 79, datë 24.7.2013**

**PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “ENERGY PARTNERS - AL” SHPK ME NR. 118, SERIA PV11K, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 7, DATË 2.2.2011**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 13, 14 pika 2, 15 pika 1, pika 2 germa “b” pika 3 pika 4 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, pikat 2.3 dhe 2.4 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.7.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Energy Partners - AL” sh.p.k. për ndryshimin e licencës nr. 118, seria PV11K, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 7, datë 2.2.2011 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Energy Partners - AL” sh.p.k. plotëson kërkesat e “Rregullores së procedurave të licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”:

Informacioni me shkrim, ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës (është plotësuar tërësisht).

- Neni 15, pika 4, germa “b”:

Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence (është plotësuar tërësisht).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Modifikimin e licencës së shoqërisë “Energy Partners - AL” me nr. 118, seria PV11K, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et “Shkalle”, “Cerrunje”, “Plesha”, “Bejni 1, 2” dhe “Klos” me fuqi 72 KW, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 7, datë 2.2.2011.

2. Emërimi i HEC-ve do të jetë: “Shkalle”, “Cerrunje 1”, “Cerrunje 2”, “Rrupe” dhe “Klos”, fuqia totale e instaluar e tyre do të jetë 12,750 MW.





3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Sokol Ramadani

**VENDIM**  
**Nr. 80, datë 24.7.2013**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC TRESKA” SHPK NË AKTIVITETIN E  
PRODHIMIT TË ENERGIJË ELEKTRIKE NGA HEC-ET “TRESKA 2”, “TRESKA 3”  
DHE “TRESKA 4”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “a” dhe nenit 10 pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18 pika 1 germa “a” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.7.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HEC Treska” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “HEC Treska” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të licencojë shoqërinë “HEC Treska” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Treska 2” me fuqi 0,62 MW, “Treska 3” me fuqi 0.4 MW dhe “Treska 4” me fuqi 3.6 MW.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**

**VENDIM**  
**Nr. 81, datë 24.7.2013**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HIDRO ENERGY SOTIRA” SHPK NË AKTIVITETIN  
E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC  
“SOTIRE 1&2”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “a” dhe nenit 10 pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18 pika 1 germa “a” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.7.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hidro Energy Sotira” sh.p.k. nga HEC “Sotire 1&2”, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hidro Energy Sotira” sh.p.k. nga HEC “Sotire 1&2”, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të licencojë shoqërinë “Hidro Energy Sotira” sh.p.k në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Sotire 1&2” me fuqi 2,2 MW.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**



**VENDIM**  
**Nr. 82, datë 31.7.2013**

**MBI KËRKESËN PËR MIRATIM TË SKEDULIMIT TË PAGESAVE TË  
“CEZ SHPËRNDARJE” SHA (NË ADMINISTRIM TË PËRKOHSHËM), PËR MUAJIN  
GUSHT 2013**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, dhe 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimin nr. 5, datë 21.1.2013 “Për vendosjen e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. në administrim të përkohshëm dhe emërimin e administratorit të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., në zbatim të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 4, datë 21 janar 2013 “Për heqjen e licencave për aktivitetin e shpërndarjes të energjisë elektrike dhe aktivitetit të furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a.”, nenit 14 të rregullores “Për procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 10.1.2013, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 31.7.2013, pasi shqyrtoi propozimin e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” dhe relacionin e drejtorive teknike të ERE-s,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e skedulimit të pagesave të “CEZ Shpërndarje” (bashkëlidhur këtij vendimi) për muajin gusht 2013.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë “CEZ Shpërndarje” për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**

Muaji	Gusht 2013		
<b>Parashikimi I arketimeve:</b>	<b>3,500,000,000.00</b>		
	<b>Detyrim i vjeter</b>	<b>Detyrim i ri</b>	<b>Totali</b>
<b>Shpenzime page</b>		<b>185,000,000</b>	<b>185,000,000</b>
<b>Taksa</b>		<b>656,038,477</b>	<b>656,038,477</b>
Gjoha		200,000,000	200,000,000
TVSH		200,000,000	200,000,000
Dogane		2,000,000	2,000,000
Takse TV		40,000,000	40,000,000
TAP		22,215,158	22,215,158
Tatimi ne burim		3,000,000	3,000,000
Takse automjetesh		2,000,000	2,000,000
Taksa Lokale		18,663,998	18,663,998
Sigurime Shoqerore		56,994,366	56,994,366
Tatimi fitimi i shoqerise		111,164,955	111,164,955
<b>Qira dhe roje</b>		<b>51,000,000</b>	<b>51,000,000</b>
Qira		13,000,000	13,000,000
Roje		27,000,000	27,000,000
Qira automjeti		11,000,000	11,000,000
<b>Karburant</b>		<b>30,000,000</b>	<b>30,000,000</b>
<b>Shpenzime poste, telefoni, interneti</b>	-	<b>104,000,000</b>	<b>104,000,000</b>
Shpenzime telefoni		10,000,000	10,000,000
Shpenzime interneti		2,000,000	2,000,000
Shpenzime poste		2,000,000	2,000,000
Poshta Shqiptare		60,000,000	60,000,000
Shpenzime Permbarim		30,000,000	30,000,000
<b>Shpenzime mirembajtjeje, printime dhe reklame</b>	-	<b>68,000,000</b>	<b>68,000,000</b>
Mirembajtjeje		30,000,000	30,000,000
Reklame		5,000,000	5,000,000
Shpenzime udhetimi			-
Ujesjellesa		3,000,000	3,000,000
Printim shperndarje fature		30,000,000	30,000,000
<b>Blerje materialesh</b>		<b>150,000,000</b>	<b>150,000,000</b>
<b>Investime</b>		<b>250,000,000</b>	<b>250,000,000</b>
KESH sha		700,000,000-1,000,000,000	<b>850,000,000</b>
OST sha		300,000,000-400,000,000	<b>350,000,000</b>
ERE			
CEZ Albania (SHSA)	80,000,000		<b>80,000,000</b>
Konsulence		15,000,000	<b>15,000,000</b>
<b>Kredi CEZ a.s</b>			-
<b>Energji CEZ a.s</b>			-
Import energjie		570,000,000	<b>570,000,000</b>
Importi energjie i papaguar	300,000,000		<b>300,000,000</b>
Te tjera		50,000,000	<b>50,000,000</b>
<b>Totali mujor</b>	<b>380,000,000</b>	<b>3,329,038,477</b>	<b>3,709,038,477</b>

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Hyri në shtyp më 15.8.2013  
Doli nga shtypi më 15.8.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2013

Çmimi 30 lekë